



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr. Prot. 3596

Tiranë, më 27.06.2017

LËNDA: Ftesë për informacion

DREJTUAR: Të gjithë subjekteve zgjedhorë

Të nderuar,

Me VKM nr. 473, datë 01.06.2017 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë” është ngritur dhe funksionon Task-Forca, e cila koordinon procesin e monitorimit sipas këtij vendimi.

Në zbatim të detyrave të masave operacionale për ditën e zgjedhjeve të miratuara nga Task-Forca në mbledhjen e datës 23.06.2017, lutemi dërgimin brenda ditës **së nesërme informacionit më poshtë:**

1. Sa raste keni konstatuar/referuar pranë institucioneve apo Kryeministrisë, ditën e zgjedhjeve dhe gjatë procesit të numërimit, për përfshirje të punonjësve të administratës shtetërore (pa përfshirë rastet për punonjësit e policisë së shtetit) në veprimtari në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe kodin penal për vepra penale që prekin sistemin demokratike të zgjedhjeve;
2. Sa raste keni konstatuar/referuar pranë Ministrisë së Brendshme apo Kryeministrisë, ditën e zgjedhjeve dhe gjatë procesit të numërimit, për përfshirje të punonjësve të policisë së shtetit, në veprimtari në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe kodin penal për vepra penale që prekin sistemin demokratike të zgjedhjeve;

Informacionin që do të dërgoni me shkresë, për shpejtësi, lutemi ta dërgoni të skanuar në adresën e e-mailit: Sonila.Balla@kryeministria.al

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

LEDINA MANDIJA